

20110451206

L I G J
PËR GARANCI TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NDAJ DETYRIMEVE SIPAS
MARRËVESHJES PËR HUA PËR FINANCIMIN E PUNËVE PARAPRAKE DHE
PËRGATITORE PËR PROJEKTIN "FUSHA E LLUKOVËS DHE SJELLJA E
UJËRAVE TË KORABIT", QË DO TË LIDHET NDËRMJET BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM-BANKËS BOTËRORE DHE
SHA ELEM

Neni 1

Republika e Maqedonisë e garanton përmbushjen e detyrimeve dhe plotësimin e dispozitave të Marrëveshjes për hua, për financimin e punëve paraprake dhe përgatitore për Projektin "Fusha e Llukovës dhe sjellja e ujërave të Korabit" që do të lidhet ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim-Bankës Botërore dhe SHA ELEM në shumë prej 3 000 000 dollarësh amerikanë, në afate dhe kushte të parapara në Marrëveshje për hua, nëse SHA ELEM nuk i plotëson dhe servison detyrimet nga Marrëveshja për hua.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji përcaktohen me Marrëveshje për hua, që do të lidhet ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore dhe SHA ELEM për financimin e punëve paraprake dhe përgatitore për Projektin "Fusha e Llukovës dhe sjellja e ujërave të Korabit".

Neni 3

Të gjitha detyrimet që dalin nga Marrëveshja për hua nga neni 1 i këtij ligji, si dhe servisimin e huas do ta kryejë SHA ELEM nga të hyrat që i realizon, në afate dhe kushte të përcaktuara në Marrëveshje për hua.

Neni 4

Nëse më 29 qershor 2012 ose para 29 qershorit 2012 lidhet Marrëveshja për hua për Projektin "Fusha e Llukovës dhe sjellja e ujërave të Korabit" ndërmjet SHA ELEM dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Bankës Botërore, shuma e plotë e mjeteve të tërhequra të huas nga neni 1 i këtij ligji bashkë me kumatën e llogaritur, do t'i paguhen Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Bankës Botërore në mënyrë dhe kushte që do të parashihen në Marrëveshje për hua për Projektin "Fusha e Llukovës dhe sjellja e ujërave të Korabit".

Nëse më 29 qershor 2012 ose para 29 qershorit 2012, për çfarëdo shkaqe nuk lidhet Marrëveshja për hua nga paragrafi 1 i këtij neni ose e njëjta lidhet, por pastaj ndërpritet dhe nuk bëhet efektive, pagesa e huas nga neni 1 i këtij ligji do të kryhet:

a) nëse shuma e mjeteve të tërhequra të huas nga neni 1 i këtij ligji nuk e tejkalon shumën prej 50 000 dollarësh amerikanë, atëherë kjo shumë bashkë me kumatën e llogaritur do t'i paguhen Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Bankës Botërore përnjëherë në afat jo më herët se 60 ditë pas marrjes së njoftimit nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore për detyrimin e arritur.

b) nëse shuma e mjeteve të tërhequra të huas nga neni 1 i këtij ligji e tejkalon shumën prej 50000 dollarësh amerikanë, atëherë kjo shumë bashkë me kumatën e llogaritur do t'i paguhen Bankës Botërore në dhjetë këste të barabarta gjysmëvjetore, me ç'rast kësti i parë do të arrijë për pagesë në afat jo më herët se 60 ditë pas marrjes së njoftimit nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Banka Botërore për detyrimin e arritur.

Shkalla e kamatës është LIBOR gjashtëmujor në dollarë amerikanë me shtrirje të fiksuar dhe do të paguhet çdo 15 janar dhe 15 korrik të vitit.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella që dalin nga Marrëveshja për hua dhe Marrëveshja për garanci, Ministria e Financave dhe SHA ELEM do të lidhin marrëveshje të veçantë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.